

## KËRKESË ANKIMORE

**Drejtuar:** Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

**Adresa:** Rruga "Ibrahim Rugova", Ndërtesa nr. 4: Tiranë

ANKUESI	
Subjekti Ankues	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. i telefonit Koalicioni "Bashkë Fitojmë" 0697839115 / 0696178916
KOALICIONI "BASHKË FITOJMË" (BF)	

OBJEKTI I ANKIMIT	
<ol style="list-style-type: none"><li>Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 360, datë 15.04.2023 "Për Miratimin E Përmbajtjes Së Fletës Së Votimit Për Kandidatët Për Kryetar Bashkie, Bashkia Tiranë, Për Zgjedhjet Për Organet E Qeverisjes Vendore Të Datës 14 Maj 2023";</li><li>Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 363, datë 15.04.2023, "Për Miratimin E Përmbajtjes Së Fletës Së Votimit Për Kandidatët Për Kryetar Bashkie Në 60 Bashki, Për Zgjedhjet Për Organet E Qeverisjes Vendore Të Datës 14 Maj 2023"; dhe</li><li>Shfuqizimin e këtyre vendimeve, duke vendosur: Ndryshimin e përmbajtjes së Fletës së Votimit për Kandidatët Për Kryetar Bashkie Në 61 Bashkitë e Vendit, për Zgjedhjet Për Organet E Qeverisjes Vendore Të Datës 14 Maj 2023, duke hequr Logon e Partive dhe/pse të Koalicioneve, nga përmbajtja e fletës së votimit për Kandidatët për Kryetar Bashkie.</li></ol>	

TITULLI I VENDIMIT	
Vendimi	Vendimi 360, "Për Miratimin E Përmbajtjes Së Fletës Së Votimit Për Kandidatët Për Kryetar Bashkie, Bashkia Tiranë, Për Zgjedhjet Për Organet E Qeverisjes Vendore Të Datës 14 Maj 2023"; si dhe Vendimi 363, "Për Miratimin E Përmbajtjes Së Fletës Së Votimit Për Kandidatët Për Kryetar Bashkie Në 60 Bashki, Për Zgjedhjet Për Organet E Qeverisjes Vendore Të Datës 14 Maj 2023"

Nr.	Datë
360 dhe 363	15/04/2023

### Vendimi nr. 360 i KSHZ:

- Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të



FN

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Vendimi nr. 363 i KSHZH:

1. Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 60 bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

#### BAZA LIGJORE:

Neni 4, pika 1 e Kushtetutës së Shqipërisë; Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, Neni 65, 98, si dhe nenet 136, 139, 140, 141 e vijues të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 8, datë 23.2.2023, i Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

#### PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimet e tij nr. 360 dhe 363, datë 15.04.2023 ka vendosur : *Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi* [Vendimi Nr. 360 i KSHZH], si dhe ka vendosur po atë ditë *Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 60 bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi* [Vendimi nr. 363 i KSHZH].

Në datë 14 Prill 2023, me anë të komunikimeve elektronike me e-mail, përfaqësuesit e Koalicionit Bashkë Fitojmë i përcollën vërejtjet dhe sugjerimet e tyre KQZ lidhur me përmbajtjen por edhe paraqitjen grafike të fletës së votimit si për Kryetar ashtu edhe për Keshillat Bashkiak në zgjedhjet e 14 Majit 2023.

Në seancën publike të datës 15.04.2023 përfaqësuesit i Koalicionit Bashkë Fitojmë i kërkoi zyrtarisht Komisionerit Ilirjan Celibashi mos-përfshihej logo/emblema e koalicioneve dhe as logo e partive politike tek Fleta për Kryetar Bashkie në zgjedhjet e 14-Majit 2023, kjo për dy arsye:

*Së pari*, jemi përpara zgjedhjeve të pushtetit vendor, ku qytetarët Shqiptarë do zgjedhin kryetarin e tyre të bashkisë respektive dhe jo kryetarin e ndonjë partie politike ;

*Së dyti*, nuk jemi përpara zgjedhjeve të përgjithshme ku kandidatët identifikohen kryesisht me partinë apo koalicionin që i ka propozuar me listë shumë-emërore;

*Së treti*, praktika e KQZ për zgjedhjet e kaluara lidhur me Fletën e Votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie ka qene e tille qe nuk ka patur Logo partie apo koalicioni.

Fatkeqësisht Komisioneri Celibashi nuk i mori në konsideratë këto fakte dhe argumenta, duke marrë d vendimet objekt ankimi;



## FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMIMI.

Të gjitha faktet, indiciet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se vendimi i Komisionerit objekt ankimi ka ardhur në kundërshtim me kuadrin ligjor, frymen dhe germen e ligjit, por edhe praktiken e deritanishme te ndjekur nga KQZ.

Kodi Zgjedhor, në Nenin 98 “Përmbajtja e Fletës së Votimit”, parashikon se:

*“1. Fletët e votimit për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së.*

*Fleta e votimit përmban element teknik në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit, si dhe elemente të tjera identifikuese që nuk lexohen me sy të lirë.*

*2. Fletët e votimit prodhohen në blloqe pa kundërfletë. Numri i serisë së bllokut të fletëve të votimit shënohet në dokumentin që shoqëron bllokun e ambalazhuar, sipas përcaktimeve të KQZ-së.*

*3. Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. **Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë.** Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi.*

*4. Fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer.*

*5. KQZ-ja organizon hedhjen e shortit për detyrimet që rrjedhin nga ky nen, menjëherë sapo të ketë përfunduar regjistrimi i listës shumëmemërore në KQZ apo, sipas rastit, në KZAZ. Rregullat për hedhjen e shortit përcaktohen me akt normativ të KQZ-së.”.*

Nisur nga fakti se Neni 98, pika 3 i Kodit Zgjedhor nuk parashikon që Fleta e Votimit të ketë logon e koalicionit, si dhe duke marrë shkas nga praktika e ndjekur deri me tani për zgjedhjet e tjera të organizuara nga KQZ, por edhe duke patur parasysh kerkesën e Koalicionit Bashke Fitojme, gjykojme se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në gjykimin tonë ka shkelur Kodin Zgjedhor.

Nisur nga sa më sipër, KAS duhet të shfuqizojë vendimet objekt ankimi të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke e detyruar KQZ që të vendosë: **Ndryshimin e përmbajtjes së Fletës së Votimit për Kandidatët Për Kryetar Bashkie Në 61 Bashkitë e Vendit, për Zgjedhjet Për Organet E Qeverisjes Vendore Të Datës 14 Maj 2023, duke hequr Logon e Partive dhe/pse të Koalicioneve, nga përmbajtja e fletës së votimit për Kandidatët për Kryetar Bashkie.**

Përfundimisht, bazuar mbi sa u argumentua më lart, Koalicioni “Bashkë Fitojmë”,

### Kërkon:

**1. Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 360, datë 15.04.2023 “Për Miratimin E Përmbajtjes Së Fletës Së Votimit Për Kandidatët Për Kryetar Bashkie, Bashkia Tiranë, Për Zgjedhjet Për Organet E Qeverisjes Vendore Të Datës 14 Maj 2023” ;**




2. Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 363, datë 15.04.2023, “Për Miratimin E Përmbajtjes Së Fletës Së Votimit Për Kandidatët Për Kryetar Bashkie Në 60 Bashki, Për Zgjedhjet Për Organet E Qeverisjes Vendore Të Datës 14 Maj 2023”; dhe
3. Shfuqizimin e këtyre vendimeve, duke vendosur: Ndryshimin e përmbajtjes së Fletës së Votimit për Kandidatët Për Kryetar Bashkie Në 61 Bashkitë e Vendit, për Zgjedhjet Për Organet E Qeverisjes Vendore Të Datës 14 Maj 2023, duke hequr Logon e Partive dhe/pse të Koalicioneve, nga përmbajtja e fletës së votimit për Kandidatët për Kryetar Bashkie.

**PROVAT QË PARAQITEN DHE / OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE.**

1. Vendimi Nr. 360 i datës 15.04.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
2. Vendimi Nr. 363, datë 15.04.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

*Duke ju falenderuar paraprakisht,*

**PËR  
KOALICIONIN “BASHKË FITOJMË”**



Tiranë, 18/04/2023

